



Fletinformacion për Kërkimin e Dosjes Mjekësore të të Paraburgosurve

Ky fletinformacion përmban udhëzime për të paraburgosurit dhe/ose palët e treta të autorizuar nga të paraburgosurit për të kërkuar nga mjeku i Njësisë së Paraburgimit kopje të dosjes mjekësore të të paraburgosurit.

I. ROLI DHE TË DHËNAT QË MBAN SHËRBIMI MJEKËSOR

1. Mjeku i Njësisë së Paraburgimit është përgjegjës për kujdesin shëndetësor dhe mendor të të paraburgosurve dhe kryen ekzaminimin mjekësor të të paraburgosurve.¹ Ky funksion parësor pa dyshim që ka përparësi ndaj sigurimit të të dhënave mjekësore.
2. Për secilin prej të paraburgosurve, mjeku i Njësisë së Paraburgimit mban dosje mjekësore, e cila është konfidenciale dhe ruhet veças prej Dosjes Personale të të Paraburgosurit.² Rrjedhimisht, mjeku i Njësisë së Paraburgimit është pikë kontakti për të gjitha informacionet mjekësore dhe personi përgjegjës për ruajtjen e dosjes mjekësore të secilit prej të paraburgosurve.
3. Të dhënat që përbëjnë dosjen mjekësore që mban mjeku i Njësisë së Paraburgimit janë të ngjashme me ato që mbahen nga mjeku i familjes, dhe përfshijnë sa më poshtë:
 - a. shënime të analizave diagnostikuese (dhe rezultateve të tyre) nga ana e personelit të shërbimit mjekësor të Objektivit të Paraburgimit; dhe
 - b. interpretimin e specialistëve për ekzaminimet dhe diagnostikimet (dhe rezultatet) e kryera nga mjekë që nuk punojnë në Objektivin e Paraburgimit.

Të dhënat e papërpunuara që shfrytëzojnë specialistët për përgatitjen e interpretimeve të tyre zakonisht mbeten në objektet mjekësore të jashtme.

II. PARIMET DREJTUESE DHE STANDARDET

A. Parimet etike dhe standardet profesionale relevante

1. Marrëdhëniet midis mjekut të Njësisë së Paraburgimit ose punonjësve të tjerë të kujdesit shëndetësor dhe të paraburgosurve rregullohen me të njëjtat standarde etike dhe profesionale që janë në fuqi në shtetin pritës, veçanërisht:
 - a. detyra e mbrojtjes së shëndetit fizik dhe mendor të të paraburgosurve dhe parandalimi e mjekimi i sëmundjeve vetëm duke u bazuar në shkaqe klinike;
 - b. respektimi i autonomisë së të paraburgosurve në lidhje me shëndetin e tyre;

¹ KSC-BD-08-Rev1, Rregullorja e Paraburgimit, 23 shtator 2020 ('Rregullorja e Paraburgimit'), rregulla 30(4) e Rregullores së Paraburgimit. Mjeku i Njësisë së Paraburgimit dërgohet nga shteti pritës dhe caktohet me anë të miratimit me shkrim midis DHSK-së dhe Agjencisë së Institucioneve të Ndalimit të shtetit pritës për kujdesin shëndetësor dhe mendor të të paraburgosurve në pajtim me Rregulloren e Paraburgimit. Siç përcaktohet në Rregulloren e Paraburgimit, për arritjen e këtij qëllimi, mjeku i Njësisë së Paraburgimit u referohet mjekut përgjegjës për trajtimin mjekësor në Objektivin e Paraburgimit, zëvendësit të tij ose saj, ose cilitdo mjeku të dërguar nga shteti pritës. *Shih* rregullën 2 të Rregullores së Paraburgimit.

² Rregulla 36(1) e Rregullores së Paraburgimit.



- c. parimi i konfidencialitetit të informacionit mjekësor;
 - d. ndalimi absolut i kryerjes aktive ose pasive të akteve që mund të përbëjnë torturë ose ndëshkim ose trajtim mizor, çnjerëzor ose poshtërues; dhe
 - e. parimi i dhënies së pëlqimit prej të paraburgosurit për trajtim mjekësor bazuar në informacion.³
2. Të paraburgosurit gëzojnë së paku të njëjtat standarde të shërbimit shëndetësor si ato të shtetit pritës.⁴
 3. Për mjekët që punojnë në Holandë, parimet etike dhe standardet profesionale përcaktohen dhe kontrollohen nga Shoqata Holandeze Mbretërore e Mjekësisë (“KNMG”). Në komunitetin ndërkombëtar, për mjekët që punojnë në disa shtete, parimet etike dhe standardet profesionale përkufizohen dhe përditësohen nga Shoqata Botërore e Mjekësisë (“WMA”), në të cilën bën pjesë KNMG-ja.⁵

B. Marrëdhëniet mjek-pacient dhe autonomia e pacientit

1. Marrëdhëniet mjek-pacient bazohen në mirëbesim dhe komunikim të hapur lidhur me dëshirat dhe pritshmëritë e pacientëve dhe opsionet e trajtimit.⁶
2. Parimi i autonomisë së pacientit kërkon që mjeku të respektojë mendimet dhe zgjedhjet e pacientit, të cilat duhet të bëhen pa ndërhyrjen e papërligjur të personave të tjerë, bazuar në informacion të plotë, dhe jo në kundërshtim me detyrimet etike të mjekut.

C. Konfidencialiteti

1. Dosja mjekësore e të paraburgosurit, përfshirë informacionin që përmban, trajtohet sipas parimit të konfidencialitetit mjekësor.⁷ Megjithatë konfidencialiteti është e drejtë e çdo pacienti, ruajtja e konfidencialitetit është edhe detyrim profesional i mjekut.⁸
2. Mjeku i Njësisë së Paraburgimit është përgjegjës dhe jep llogari lidhur me përmbushjen e detyrimit të konfidencialitetit mjekësor për të dhënat që mban shërbimi mjekësor, edhe në rastin kur këto të dhëna vijnë nga objekte mjekësore që nuk ndodhen në Objektin e Paraburgimit.⁹

³ Rregulla 30(4) e Rregullores së Paraburgimit.

⁴ Rregulla 30(2) e Rregullores së Paraburgimit.

⁵ WMA është themeluar për “të siguruar pavarësinë e mjekëve, dhe për të punuar për arritjen e standardeve më të larta të mundshme të sjelljes etike dhe të kujdesit nga ana e mjekëve, në çdo kohë”. Shih <https://www.wma.net/who-we-are/about-us/>. WMA e ka rishikuar betimin e Hipokratit që të përputhet me Deklaratën e Gjenevës dhe ka botuar Kodin Ndërkombëtar të Etikës Mjekësore, i cili ndryshohet periodikisht. Shih <https://www.wma.net/policies-post/wma-declaration-of-geneva/> dhe <https://www.wma.net/policies-post/wma-international-code-of-medical-ethics/>.

⁶ Rregulla 30(4) e Rregullores së Paraburgimit.

⁷ Rregulla 36(1) e Rregullores së Paraburgimit.

⁸ Rregulla 30(4)(c) e Rregullores së Paraburgimit.

⁹ Rregulla 36(1) e Rregullores së Paraburgimit.



D. Pëlqimi i bazuar në informacion

1. Përpara nxjerrjes së të dhënave mjekësore të të paraburgosurit, mjeku i Njesisë së Paraburgimit i kërkon të paraburgosurit të japë pëlqimin e vet të bazuar në informacion.¹⁰
2. Çdo nxjerrje e të dhënave mjekësore pa pëlqimin e bazuar në informacion të të paraburgosurit bëhet mbi bazën e domosdoshmërisë së përmbushjes së një qëllimi legjitim dhe në përpjesëtim me qëllimin në fjalë. Mjeku i Njesisë së Paraburgimit mund t'i nxjerrë të dhënat mjekësore të të paraburgosurit pa marrë pëlqimin paraprak të tij të bazuar në informacion për mbrojtje nga një kërcënim i rëndë dhe i menjëhershëm ndaj shëndetit ose sigurisë së të paraburgosurit ose të personave të tjerë, ose kur këtë e kërkon një interes legjitim që përlligj nxjerrjen në përputhje me Ligjin Nr. 05/L-053, rregullat në fuqi të shtetit pritës dhe rregullat e etikës profesionale.¹¹
3. Pëlqimi i bazuar në informacion mund të merret nga mjeku i Njesisë së Paraburgimit me shkrim ose me gojë. Ky pëlqim mund të merret vetëm pas konsultimit midis mjekut të Njesisë së Paraburgimit dhe të paraburgosurit. Gjatë këtij procesi, është e rëndësishme që i paraburgosuri të kuptojë qëllimin, përmbajtjen dhe pasojat e mundshme të nxjerrjes që synohet. Gjatë këtij procesi, mjeku i Njesisë së Paraburgimit zbaton dhe vepron në bazë të parimeve etike dhe standardeve profesionale përkatëse.
4. Në përfundim të procesit të konsultimit lidhur me pëlqimin e bazuar në informacion, mjeku i Njesisë së Paraburgimit nxjerr vetëm ato të dhëna të posaçme për të cilat është dhënë pëlqimi i bazuar në informacion.¹² Rrjedhimisht, pëlqimi i bazuar në informacion mund të jepet vetëm në lidhje me të dhëna që ekzistojnë në kohën e procesit të konsultimit, dhe mjeku i Njesisë së Paraburgimit nuk duhet të nxjerrë asnjë të dhënë për të cilën i paraburgosuri nuk ka dhënë pëlqimin e bazuar në informacion.

III. KËRKESA PËR MARRJEN E DOSJES MJEKËSORE

A. Kërkesa e të paraburgosurit për qasje në dosjen mjekësore

1. Në pajtim me rregullën 36(5) të Rregullores së Paraburgimit, i paraburgosuri ka të drejtë të ketë qasje në të gjitha të dhënat e përfshira në dosjen e vet mjekësore në përputhje me cilindo udhëzim të zbatueshëm, të miratuar ose të nxjerrë sipas rregullës 4 të Rregullores së Paraburgimit, përveçse kur ka shkaqe të arsyeshme për të besuar se nxjerrja e të dhënave të caktuara mund t'i shkaktojë të paraburgosurit lëndim të rëndë fizik ose mendor.
2. Një kërkesë të tillë i paraburgosuri ia dërgon drejtpërdrejt mjekut të Njesisë së Paraburgimit, duke i shpjeguar qartë qëllimin e kërkesës si dhe të dhënat e veçanta në të cilat kërkon qasje. Si alternativë, kjo kërkesë mund t'i dërgohet shefit të paraburgimit. Në rastet kur kërkesa i dërgohet shefit të paraburgimit, ajo i përcillet për shqyrtim mjekut të Njesisë së Paraburgimit.
3. Duke pasur parasysh burimet e disponueshme të shërbimit mjekësor, kërkesat për nxjerrjen e dosjes

¹⁰ Rregulla 36(3) e Rregullores së Paraburgimit.

¹¹ Rregulla 30(4) e Rregullores së Paraburgimit.

¹² Nuk kërkohet konsultim kur zbatohet rregulla 30(4) e Rregullores së Paraburgimit.



- mjekësore shqyrtohen në përputhje me pjesën I, paragrafin 1 më lart. Mjeku i Njesisë së Paraburgimit vendos lidhur me numrin e kopjeve.
4. Pas marrjes së kërkesës, mjeku i Njesisë së Paraburgimit nis procesin e konsultimit me të paraburgosurin.¹³
 5. Kur mjeku i Njesisë së Paraburgimit e miraton kërkesën, shërbimi mjekësor përgatit kopje të të dhënave për të cilat është dhënë miratimi, me qëllim që ato të dërgohen brenda dy javëve pas këtij miratimi. Në rastet kur kërkesa ka të bëjë me të dhëna që ruhen në objekte mjekësore jashtë Objektivit të Paraburgimit, kërkesën për këto të dhëna mund ta bëjë vetëm mjeku i Njesisë së Paraburgimit.¹⁴ Marrja e të dhënave nga objektet mjekësore jashtë Objektivit të Paraburgimit mund të zgjasë më shumë dhe ato i jepen të paraburgosurit pasi t'i ketë marrë shërbimi mjekësor. I paraburgosuri duhet të konfirmojë marrjen në dorëzim të të dhënave.
 6. Në rast se i paraburgosuri dëshiron të marrë informacione shtesë apo sqarime lidhur me ndonjërin prej të dhënave të dosjes mjekësore që i është dorëzuar, këto pyetje i dërgohen mjekut të Njesisë së Paraburgimit.
 7. Në rast se mjeku i Njesisë së Paraburgimit vendos të refuzojë apo kufizojë qasjen në të dhëna të veçanta të dosjes mjekësore të të paraburgosurit në pajtim me rregullën 36(5) të Rregullores së Paraburgimit, mjeku i Njesisë së Paraburgimit e informon për këtë të paraburgosurin duke i dhënë arsytet për refuzimin apo kufizimin e qasjes në këtë informacion. Çdo refuzim apo kufizim i tillë i qasjes në informacion dokumentohet në dosjen mjekësore të të paraburgosurit.

B. Kërkesa që një palë e tretë të ketë qasje në dosjen mjekësore

1. Kërkesa e të paraburgosurit që një palë e tretë të lejohet të ketë qasje në informacionin që përmban dosja e vet mjekësore në pajtim me rregullën 36(3) të Rregullores së Paraburgimit i dërgohet shefit të paraburgimit ose drejtpërdrejt mjekut të Njesisë së Paraburgimit. Po kështu, edhe palët e treta, përfshirë mbrojtësit, mund t'i dërgojnë drejtpërdrejt shefit të paraburgimit autorizimin e të paraburgosurit për të kërkuar qasje në informacionin që përmban dosja e vet mjekësore. Formulari i Autorizimit gjendet në Shtojcën 1.
2. Kërkesa për qasje duhet të shpjegojë qartë qëllimin e saj, të dhënat e veçanta për të cilat kërkohet qasje, si dhe kush duhet të ketë qasje. Në rast se kërkesa i dërgohet shefit të paraburgimit, ajo i përcillet për shqyrtim mjekut të Njesisë së Paraburgimit. Shefi i paraburgimit luan vetëm rolin e kanalit të komunikimit me palët e treta lidhur me këtë kërkesë.
3. Duke pasur parasysh burimet e disponueshme të shërbimit mjekësor, kërkesat për nxjerrjen e dosjes mjekësore shqyrtohen në përputhje me pjesën I, paragrafin 1 më lart. Mjeku i Njesisë së Paraburgimit vendos lidhur me numrin e kopjeve.
4. Mjeku i Njesisë së Paraburgimit konsultohet me të paraburgosurin dhe mund të kërkojë informacione shtesë për t'u siguruar se pëlqimi është dhënë në bazë të informacionit të plotë.
5. Kur mjeku i Njesisë së Paraburgimit e miraton kërkesën, shërbimi mjekësor përgatit kopje të të

¹³ Shih pjesën II(D) lidhur me pëlqimin e bazuar në informacion dhe procesin e konsultimit.

¹⁴ Shih pjesën II(C)(2) më lart.



dhënave për të cilat është dhënë miratimi, me qëllim që ato të dërgohen brenda dy javëve pas këtij miratimi. Dosja mjekësore nxirret në njëën prej mënyrave të mëposhtme:

- a. i jepet në dorë të paraburgosurit, i cili duhet të konfirmojë marrjen në dorëzim;
- b. futet në një zarf të dyllësor i cili i dorëzohet në hyrje të burgut personit të autorizuar pas paraqitjes së dokumentit të identifikimit dhe nënshkrimit të marrjes në dorëzim; ose
- c. në raste të veçanta dhe me pëlqimin e të paraburgosurit, dërgohet me postë elektronike të sigurt ku përfshihet edhe nënshkrimi elektronik i marrjes në dorëzim.

Marrja e të dhënave nga objektet mjekësore jashtë Objektivit të Paraburgimit mund të zgjasë më shumë dhe ato i jepen të paraburgosurit pasi t'i ketë marrë shërbimi mjekësor.

6. Palët e treta duhet të respektojnë konfidencialitetin e çdo dosjeje mjekësore që marrin nga shërbimi mjekësor. Personat e autorizuar me emër duhet të marrin masa që dosja të mos shpërndahet më tej në shkelje të pëlqimit të dhënë.
7. Palët e treta janë të detyruara ta kthejnë ose shkatërrojnë dosjen mjekësore që kanë marrë pas realizimit të qëllimit.
8. Duhet bërë kërkesë e re sa herë që pala e tretë kërkon që dosjen t'ua shpërndajë të tjerëve që nuk mbulohen nga marrëveshja e pëlqimit. Në mënyrë të ngjashme, kërkesë e re duhet bërë edhe për autorizimin e personave të tjerë dhe/ose në rast se ndryshon qëllimi i përdorimit.
9. Në rast se mjeku i Njesisë së Paraburgimit vendos të refuzojë apo kufizojë qasjen në të dhëna të veçanta të dosjes mjekësore të të paraburgosurit në pajtim me rregullën 36(5) të Rregullores së Paraburgimit, mjeku i Njesisë së Paraburgimit e informon për këtë të paraburgosurin duke i dhënë arsyet për refuzimin apo kufizimin e qasjes në këtë informacion. Kur është relevante, mjeku i Njesisë së Paraburgimit informon edhe palën e tretë në varësi të konfidencialitetit mjekësor. Çdo refuzim apo kufizim i tillë i qasjes në informacion dokumentohet në dosjen mjekësore të të paraburgosurit.



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Shtojca 1

PËR FLETËN E INFORMACIONIT LIDHUR ME KËRKESËN PËR TË DHËNAT MJEKËSORE TË TË
PARABURGOSURIT



Formulari i autorizimit të të dhënave mjekësore

Pacienti

Mbiemër: _____ Emër: _____

Ditëlindje: _____
dd/mm/vvvv

Palët e treta të autorizuara

Mbiemër _____ Emër: _____

Adresë _____
Rruga dhe numri _____ Qyteti _____ Posta _____ Shteti _____

Kontakti _____
email _____ telefon _____

Të dhënat mjekësore të autorizuara për lëshim

Iloji dhe subjekti specifik i të dhënave (dmth. në lidhje me cilën gjendje apo çështje mjekësore):

gjatë cilës periudhë kohore (datat nuk mund të kalojnë datën e kërkesës):

prej _____ deri më: _____
dd/mm/vvvv dd/mm/vvvv

për çfarë qëllimi (sa më shumë informacion të jepet, aq më mirë mund të lehtësohet kërkesa juaj):

Konfirmoj se “pala e tretë e autorizuar” e përmendur si më sipër mund të kërkojë qasje në “të dhënat mjekësore të autorizuara për lëshim” siç specifikohet më lart nga Shërbimi Mjekësor i Institucionit të Paraburgimit. Unë e kuptoj se asnjë document nuk do t’i jepet palës së tretë të autorizuar deri sa të kemi pasur një proces konsultimi me oficerin mjekësor për të më ndihmuar me dhënien e pëlqimit të bazuar në informacion

Firma e pacientit: _____

Data _____